



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIA KAMËZ

Nr. 164 prot.

Kamëz, më 26.12.2023

V E N D I M

Nr. 118 Datë 26/12/2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 163 DATË 21.12.2022 "PËR
MIRATIMIN E DETAJIMIT TË BUXHETIT PËR VITET 2023, 2024, 2025".**

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt. 26 /12/2023, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin nr.94 dt 21/12/2023,

Në mbështetje të:

- - Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 "Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010, "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin",
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- Udhëzimin Nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"
- Udhëzimin Plotësues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore"
- Udhëzimin Nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"
- Udhëzimin Nr. 27 datë 26.02. 2021 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024"
- Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02. 2022, per nje ndryshim ne udhezimin nr.23 dt 23.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore"
- Udhëzimin Nr. 8 datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026"
- Udhëzimin Plotësues Nr. 21 datë 07.07.2023 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit",
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr prot 22656/6 prot. date 20.12.2023 "Mbi zbatimin e aktit normativ nr.6 dt 14.12.2023".

V E N D O S I

1. Miratimin e ndryshimeve të buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2023.
2. Miratimin e ndryshimeve në tabelen e të ardhurave për vitin 2023.
3. Miratimin e ndryshimeve në tabelen e investimeve dhe funksionimi për vitin 2023.
4. Miratimin e strukture buxhetore për vitin 2023 (sipas tabeles bashkelidhur).
5. Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

